



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal i Konsultim publik mbi Planin e Social i Bashkise Puke

Data : 29.08.2025

Ora : 11:00

Vendi: Puke

Numri i pjesëmarrësve : *21 nga te cilet 11 burra 10 gra*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Plani i Social i Bashkise Puke 2025-2028*

Takimi drejtohet nga Z. Ferit Ringaj Zv.Kryetari i Bashkise i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.

- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Plani u prezantua nga Lavdie Terbuni , Pergjegjese e sektorit te ndihmes dhe perkrahjes sociale

Shpjegoi se plani eshte mbeshtetur ne Ligjin 139/2015" Per qeverisjen vendore", Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" përgatitja dhe zbatimi i Planit Social është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore.

Dokumenti në vijim është i organizuar në dy pjesë:

Pjesa e parë përmban Raportin e Vlerësimit të Nevojave, i cili jep të dhëna të detajuara mbi situatën egzistuese në këndvështrimin e (i) organizimit, strukturave dhe kapaciteteve të stafit lokal të shërbimeve të kujdesit shoqëror, (ii) individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë Pukë, (iii) shërbimeve egzistuese në territor. Kjo pjesë përmban rekomandime specifike për ndryshimin e situatës së ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Pukë mbi bazën edhe të konsultimeve të kryera me aktorët publik e jo publik në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Pjesa e Dytë përmban Planin Social të Bashkisë Pukë, i hartuar mbi bazën e nevojave për shërbime të identifikuar të individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standartet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillimit.

Metodologjia ku ne jemi mbështetur është pjese e metodologjisë së ndjekur nga sherbimi social kombëtar për politika lokale dhe synon që nepermjet:

- a) Të dhëna demografike bazë;
- b) Profili dhe karakteristikat e përdoruesve të shërbimit;
- c) Shërbimet egzistuese në territorin e Bashkisë ose që përfshin dhe Bashkinë;
- d) Shpërndarja e shërbimeve në territor;
- e) Financimi i shërbimeve aktuale;

f) Të dhëna mbi strukturat e ngritura në Bashki dhe njësi administrative në përputhje me ligjin;

g) Të dhëna krahasuese mbi buxhetin e Bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij, të kemi një vlerësim real të nevojave në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Pukës, duke u mbështetur edhe në ofrues publik dhe jo publikë ekzistues të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Pukës, organizatave jo qeveritare që operojnë në territorin e Bashkisë, përfaqësues nga sistemi arsimor, shëndetësor etj.

Në rast kur mungojnë shërbimet e ngritura nga institucionet publike, këto shërbime duhet të kontrahohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes dhe kohën dhe do të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit duke u mbështetur në nevojat specifike të individëve dhe familjeve në nevojë.

Në këtë studim janë specifikuar edhe financimet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nga se përbehen ato, roli i Bashkisë në ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, struktura përgjegjëse, gjendja ekzistuese e strukturave të njësive vendore, shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe grupeve në nevojë.

Në këtë aspekt është bërë një veshtrim i përgjithshëm shoqëror dhe social me të dhëna të specifikuar në nr. e popullsisë, shtrirjen dhe përzierjen e njësive administrative (shpërndarje e popullsisë), të dhëna për persona me aftësi ndryshe, familje të pastreha.

Të gjitha këto kanë si objektiv;

Fuqizimin e strukturave dhe kapaciteteve të shërbimeve sociale të Bashkisë, zhvillimin dhe qasjen ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale, ngritjen dhe funksionimin e rrjetit lokal të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbrojtjen dhe riintegrimin e familjeve në nevojë

Si përfundim vetë përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi plani përmban aktivitete që Bashkia të ngrejë mekanizma për të marrë mendimin e tyre në vendimarrje të rëndësishme, siç është edhe zbatimi dhe rishikimi i këtij Plan.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

U hap diskutimi

Zj. Lavdie Teibuni foli për rëndësinë e këtij plani në nubarevajtjen e politikave sociale me trajtimin e grupeve të marginalizuara. Vuri theksin tek vendosja e nevojave specifike sociale për të gjithë grupet në nevojë.

Objektivi kryesor është fuqizimi i Strategjik të gjithë strukturave sociale të Bashkisë duke kërkuar bashkëpunim ndërinstitucional dhe kombëtar. Problematikat kryesore: papunësia, dhuna . kërkesa për një kujdes të veçantë për të moshuarit.

Prioriteti kryesor është fuqizimi i qendrës për të moshuar në Bashkinë Puke.

Gjithashtu të shtohen struktura organike dhe staf për plotësimin dhe zbatimin e projekteteve me karakter social.

Gjithashtu në bashkëpunim me zyrën e punësimit të hapen kurse profesionale dhe të punësohen personat e papunë.

Z. Feit Ringaj dhe Znj. Mirjana Selaman ngriten problemin e subvencionimit të familjeve në nevojë, po kështu theksuan se duhet të shtohet një subvencion i veçantë për familjet në nevojë për fëmijet që vijnë shkollën. Me përfitimin e projekteve të tilla do të bëhet e mundur të sigurohen subvencione të tilla , që përmirësojnë cilësinë e jetës të familjeve në nevojë. U mbyll diskutimi duke falënderuar të pranishmit.


Mbajtësi i procesverbalit

Iris Latifi



Sekretari i Këshillit

Hazbi Teibuni



Lista e pjesemarrësve ne konsultimin me publikun : date 29.08 .2025
 "Per prezantimin e planit social te Bashkise Puke 2025-2028"

Nr	Emri Mbiemri	Institucioni	Nr. kontaktit	Firma	Verejtje
1	Xaydie Terbecu	Bashkia e Pukes	0683486323		
2	Eldisa Fetai	Mjeandia Qendrore	0698207105		
3	Enigert Mataj	M. Ad. Rrepe	0685658911		
4	Imkrisno Selimo	Kop. E. 22 V. K. 2	0674876478		
5	Angje Mula	Kop. E. Elukit	0682563149		
6	Nelise Semihun	Kop. E. Elukit	0682340103		
7	Ylli Hadry	Saleshin	0673924301		
8	Vladimir Zefaj	Sbsh. J. nani	0682031100		
9	Haziri Teshi	Bashkia e Pukes	0672659458		
10	Shirvan Suta	Bashkia e Pukes	0683486362		
11	IRIS LATIFI	B. Puke	0692867471		
12	Florinda Dedaj	D. Puke	0699705052		
13	SOKOL GRUHI	B. Puke	0682027302		
14	Razir RINBA	B. Puke	0686341873		
15	Ilir, H. J. H. H. H.	K. P. P. P. P.	0697791008		
16	VINJOLA KULCI	DR. KONVICTI	0696310788		
17	HADIJE HYSENI	Edukatore	0686187749		
18	UJOLLA DQGI	Qytetore P. P.	0688371464		
19	Blenda Jemaj	ANAPURK	0692422741		
20	Anila Cenoj	Penosise sociale B.P.	0692257348		
21	Beror Kenci	Antoni Keshilli	0688371464		
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					

sekretari i bashkisë